



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 762 prot

Roskovec, më 30.01/2025

VENDIM

NR 5 .DATË 29.01 .2025

“PËR MIRATIM TË PROJEKTEVE PRIORITARE PËR BASHKINË ROSKOVEC ”

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec dhe në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 29,
Në zbatim të nenit 16, të Ligjit Nr. 8756, dt. 26.03.2001, “Për Emergjencat civile” ,ligjin Nr.107/2014, datë 31.07.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 dhe neni 13, dhe VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, ”Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e projekteve prioritare të cilat kanë nevojë për ndërhyrje emergjente, që kanë dalë pas kontrolleve në terren të grupit teknik të Bashkisë Roskovec dhe ekspertëve të jashtëm në periudha të ndryshme të vitit, si dhe nga eksperiencat e mëparshme të fatkeqësive natyrore, për realizim projekti, për financim apo për zbatim projekti, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronave (DPZHTMP) për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Lista e projekteve prioritare:

- 1- “Rikonstrukcion i objektit ekzistues të shkollës 9 - vjeçare “Ali Sollaku” dhe i ambjenteve sportive, Ndërtimi i shkollëve të emergjencës dhe Godina e Re e Palestrës së kësaj shkolle” në fshatin Vidhisht, Bashkia Roskovec”.
- 2- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në Qytetin Roskovec
- 3- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kurjan
- 4- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Kuman
- 5- Riparim I shtresave sipërfaqësore të rrugëve në NJA Strum
- 6- Ndërtimi i unazës Perëndimore (e cila ka 3 nënobjekte)
 - Ndërtimi i tregut agro-ushqimor
 - Terminali i autobusave ndërqytetas
 - Rrugët lidhëse
- 7- “Rritja e sigurisë dhe përmirësimi I aftësisë ujëmbledhëse në rezervuarin e Kurjanit , Bashkia Roskovec”
- 8- “Rehabilitimi dhe rritja e sigurisë në digën e cervenit dhe rindërtimi i barazhit e mbrojtje nga grryerjet e përroit të buallit, lagjja Stan, njësia administrative Kurjan”
- 9- Ndërtimi I kopshtit dhe cerdhes Suk1
- 10- Marrja e masave për transferimin e banorëve të zonës së shkarjes Mbërs.
- 11- Rehabilitimi Urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec, (faza I), me keto nenobjekte:
 - Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare
 - Ndërtimi i parkut të ri të qytetit
 - Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
 - Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)
- 12- Rikonstrukcioni i ujësjellësit të Njësisë Administrative Kuman
- 13- Ndërtim i ujsellësit të fshatit Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.
- 14- Rikualifikim urban i qëndrave të fshatrave.
- 15- Sistemi fotovoltaiik për vetkonsum në stacionet e pompimit Arapaj, Metushaj, Jagodinë.
- 16- Sistem fotovoltaiik për ngrohje në godinat e arsimin parauniversitar.
- 17- Rijetezim i ambjenteve sportive në territorin e Bashkisë Roskovec.
- 18- Linjë përpunimi të perimeve të fushës dhe përpunim i produktit ndryshe.
- 19- Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i ujitjes në rezervuarin e Kurjanit.
- 20- Përmirësimi i ujitjes në fshatin Suk 1,
- 21- Rehabilitimi i përroit të Vidhishtës (përgjat fshatit),
- 22- Njësi përpunimi, grumbullimi, laborator dhe markimi i vajit të ullirit.


- 23- Linja e përpunimit të produktit ndryshe
- 24- Rivitalizimi i pyllit të Luarit dhe parkut rekreativ
- 25- Krijimi I shtegut i bicikletave
- 26- Rikonstruksioni total i kishës së Shën Gjergjit (Monument kulture)
- 27- Pyllëzimim e liqenit të Kurjanit
- 28- Pyllëzimi i brezit të gjelbër, Suk-Jagodinë- Marinëz.
- 29- Krijimi i parkut zero karbon.
- 30- Sistemi I ndricimit rrugor me energji të rinovueshme

Konceptoi: *A.Hoxha*

Miratoi: *E.Hoxha*

Konfirmoi : *D.Hoxha*

(Sasia e ekzemplarëve të shtypur 3(tre))



KRYETAR
Majlinda Bufi

